



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES

# NJOFTIM

**Qendra e Personel Rekrutimit,  
do të rekrutojë kandidatë për ushtarë/detarë aktiv në FA**

## **Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për ushtarë/detarë aktiv:**

- të jetë shtetas shqiptar;
- të mos jetë në ndjekje penale, në proces gjykimi penal apo i dënuar nga gjykata për vepra penale;
- të ketë figurë të pastër morale dhe të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin;
- të mos ketë probleme me deportimin;
- të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale;
- moshë minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtarë/detarë aktiv nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç, ndërsa për personelin mjekësor moshën 32 vjeç;
- të ketë kryer arsimin minimum 9 vjeçar brenda ose jashtë vendit;
- të ketë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat;
- të jetë vlerësuar i aftë nga Komisioni Mjekësor Ushtarak;
- të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

## **Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët për ushtarë/detarë aktiv:**

- kërkesë me shkrim;
- fotokopjen e kartës së identitetit;
- dy fotografi të përmasave 4 x 6 cm dhe dy fotografi të përmasave 9 x 12cm;
- fotokopje të noterizuar të çertifikatës së arsimit 9-vjeçar, ose diplomës së arsimit të mesëm apo të lartë;
- diplomë, dëshmi apo certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), të noterizuara;
- raport i aftësisë në punë të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore së vendbanimit, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje infektive dhe të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale të jetës;
- ekzaminimet mjekësore për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe /ose bankat e gjakut apo Drejtoritë e Shëndetit Publik;
- kandidati i shpallur fitues, brenda 2 javëve, duhet të sjellë në Qendrën e Personel Rekrutimit edhe dëshmi penaliteti; vërtetim nga prokuroria; vërtetim nga gjykata.

**Informacion më të detajuar mund të merrni edhe pranë seksionit të rekrutimit të qarkut.**

**Aplikimi bëhet personalisht pranë zyrës së Pritjes në Qendrën e Personel Rekrutimit.**

**Afati për regjistrimi i kandidatëve është deri më datë 09.12.2021.**

0683300680

**Adresa: Qendra e Personel Rekrutimit, Rruga e "Dibrës" (Ish-Shkolla e Bashkuar), Tiranë.**